



Vrulli i deglobalizimit: Fundi i globalizimit dhe plagët e tij

Description

Ovimir Anjum

Përktheu: Arjol Guni

Në vitin 2009, *The Economist* shkruante se, përkundër dogmës së pranuar se globalizimi është i pakthyeshëm, “integrimi i ekonomisë botërore është në zbrapsje pothuajse në të gjitha frontet.”^[1] A po hyn bota jonë në një fazë të deglobalizimit mbasi përjetoj dekada të tëra të globalizimit, dhe a duhet ta mirëpresim në këtë ndryshim? Teksa globalizimi ka çuar më tutje përhapjen e kulturës dhe dijes liberale dhe konsumeriste “perëndimore” në mbarë botën, a do të krijonte globalizimi një hapësirë të mirëfilltë për një ripërtëritje e rikthim të urtësisë së kulturave antike, dhe të na mundësojë të zgjidhim problemet e nihilizmit shpirtëror, pabarazisë, tiranisë, dhe ekocidit? Apo, do të ishte thjesht një ndryshim sipërfaqësor, që ndërthur aspektet më të këqija të hedonizmave moderne dhe tiranive tradicionale? Në qoftë se ngritja dhe konsolidimi i kapitalizmit autokratik dhe etno-nacionalizmit në botën moderne janë ndonjëfarë aludimi, oguret e deglobalizimit janë korb të zeza. A është deglobalizimi i mirë, i keq, apo thjesht i pashmangshëm? Çfarë mund të bëhet në lidhje me të? Përshtatja ndaj rendit të ri botëror mund të jetë një çështje për jetë a vdekje për shumë popuj, për mënyra të shumta jetese, kultura, ide, dhe institucione. Disa korpuse studimore – përfshirë ato nga historianë, sociologë, filozofë politikë, ekonomistë, dhe mbi të gjitha, një akademizëm të përtërirë të Islamit – do të duhet të angazhohen në mënyrë që kjo pyetje të marrë një përgjigje.

S’ka vizion që të jetë i mundur pa kuptuar më parë të shkuarën. Nuk mund të kemi një tablo të të ardhmes pa patur një panoramë të të kaluarës. Mbas pothuajse gjysmë shekulli të stuhisë së ashpër të globalizimit që e kapi ymetin mysliman gafil dhe të papërgatitur, erërat po fillojnë të ndryshojnë. Të ndarë në shtete të papërfillshme që kolonizuesit ua formuan për t’i kontrolluar më mirë dhe për ta shfrytëzuar këtë në fundin e Luftës së Dytë Botërore, bota myslimane u bë një epruvetë për ideologjitë e ndryshme sekulare nacionaliste, si dhe fusha e shahut për luftërat nën tryezë të superfuqive gjatë çerek shekullit të fundit. Pavarësisht nga përpjekjet e hershme nga udhëheqësit e shteteve të reja, siç ishte Organizata e Bashkëpunimit Islam (themeluar në 1969), bota myslimane, pa një qendër, lidhë dhe vizion të fortë të përbashkët, e gjeti veten si një anije pa timon teksa politika e Luftës së Ftohtë i hapi rrugën politikës neoliberalë. Rendi i ri botëror uni-polar, i cili në vitet 1990 filloi të njihej si

globalizëm, mund të jetë në prag të fundit të tij, duke e lënë botën me një set fitimtarësh dhe humbësish që janë të ndryshëm nga ata që gjeti në fillim. Përveç korporatave multinacionale dhe elitave ekonomike dhe politike në Veriun global, ndër “fitimtarët” e tij ishin elitat dhe madje edhe seksione të klasave të mesme në kombe të caktuara post-koloniale që më herët kishin qenë të varfëra, siç janë Kina dhe India, ku kalbëzimi i thellë moral dhe social ka shoqëruar modernizimin ekonomik. Suksesi i tyre relativ në të shfrytëzuarit e fryteve të globalizmit u mundësua falë disa karakteristikave të përbashkëta: këto ishin ekonomi të mëdha që kishin zhvilluar tashmë institucione politike të qëndrueshme dhe të fuqishme (por jo domosdoshmërisht të drejta apo të mira). Ndonëse vendet myslimane, në tërësi, nuk kanë performuar mirë në asnjë aspekt, globalizmi megjithatë ka qenë një bekim i maskuar për popullësitë myslimane (sikundërse duhet të jetë detyrimisht edhe çdo gjë për besimtarët!) Ai ndërlihi pjesë të ndryshme të botës myslimane si edhe mundësoi shfaqjen e komuniteteve të konsiderueshme në të gjithë Veriun global. Media kombëtare e kontrolluar nga shteti ia la vendin satelitit dhe mediave sociale, duke lehtësuar kësodore pranimin e thellë në gjirin e masave myslimane të vlerave të përbashkëta dhe të vuajtjes së njëjtë – si edhe zhvillimin e diskurseve dhe debateve myslimane globale. Forcat ekonomike dhe politike që lehtësuan këto ndryshime globalizuese tani po ia lënë vendin një rendi të ri botëror multi-polar i cili pa diskutim do të përmbysë shumë prej aspekteve kyçe të globalizmit. A do të sjellë ky ndryshim lehtësim dhe nder në komunitetin e Pejgamberit të Begatuar, apo mos vallë do ta varfërojë atë edhe më tutje, duke përmbysur ato fitime të pakta që janë arritur deri me tani dhe duke acaruar pabarazinë dhe tiraninë? Ulemaja myslimane, intelektualët, dhe sociologët do të bënin mirë që të pranonin kërcënimet dhe mundësitë që ofrohen nga epoka e ardhshme, dhe aq më mirë nëse ofrojnë vizione dhe plane veprimi për një të ardhme të përbashkët për Ymetin.

Globalizmi

Le të marrim fillimisht në shqyrtim dukurinë e *globalizmit*, sfidat e të përkufizuarit që reflektojnë mbi vështirësinë e asaj se si të përkufizohet dhe detektohet *deglobalizimi*. Literatura bazë e globalizmit e identifikon atë si një dukuri historike që është shfaqur në faza të ndërprera në mënyra të ndryshme. Dy fazat e fundit të globalizimit, gjegjësisht i gjati shekull i nëntëmëbëdhjetë që mori fund në vitet 1930 dhe faza më imediate që nisi në vitet 1980, të dyja kanë patur implikime thellësisht trazuese për një pjesë të madhe të botës. Faza e parë profetizoi, në mos kompromentoi, darën koloniale të Europës Perëndimore, kurse fazën e dytë rendi botëror amerikan e shprehu në trajtën e kapitalizmit global me qendër në SHBA. Koncepti i globalizmit mbeti thellësisht i kontestuar madje edhe atëherë kur pothuajse të gjithë pajtoheshin se ai po ndodhte; studiuesit patën mospajtime të gjera në lidhje me atë nëse është një proces i vetëm apo një ermër për procese të shumëfishta, dhe në lidhje me atë se çfarë janë ato procese në vetvete. Një set themelor i përkufizimeve konvergjonte mbi globalizmin si një intensifikim i marrëdhënieve sociale mbarëbotërore dhe një intensifikim i tregut botëror, shpesh në kurriz të dobësimit të ndërlihdshmërisë lokale dhe kombëtare.^[2] Termi globalizëm u shpik në vitet 1960, por pushtoi botën stuhishëm në vitet 1990 mbas rënies së Murit të Berlinit. Fill pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik hynë në vakumin e lënë nga perandoritë koloniale britanike dhe franceze, me SHBA-në si hegjemoni i ri, me Kombet e Bashkuara si krahu diplomatik i *Pax Americana-s* së re, dhe me dollarin amerikan si standardi i ri i shkëmbimit. Lufta e Ftohtë u kuptua në një masë të madhe si një konflikt ideologjik ndërmjet dy versioneve të modernitetit: moderniteti atlantik (këmbyerazi, moderniteti i zhvilluesve të hershëm) që mbronte kapitalizmin; dhe reaksioni ultramodern ndaj atij moderniteti, që lindi në Europën kontinentale dhe erdhi në pushtet në formën e Bashkimit Sovjetik. Lufta e Ftohtë ishte epoka e përparësisë së politikës mbi ekonominë. Forma e shtetit-komb u konsolidua në mbarë botën kryesisht për shkak se fitimtarët e Luftës së Dytë

Botërore gjykuan se zhvillimi i varfër dhe rebelimet ideologjike ishin kërcënimet kryesore ndaj këtij rendi; ata krijuan institucione globale për të mbështetur shtetet në jetësimin e programeve të zhvillimit. Modeli ekonomik i kapitalizmit të administruar nga shteti, i njohur gjithashtu si teoria e zhvillimit, qe propozuar nga John Maynard Keynes fill pas katastrofave të shkaktuara nga një fazë e hershme e kapitalizmit të pafrë që kishte çuar në Depresionin e Madh në vitet 1930. Reaksioni ndaj ekonomisë keqnesiane nga ana e bizneseve të mëdha në vitet 1970 çoi në master planin që i dha jetë një tjetër faze të globalizimit, gjegjësisht kur në vitete 1980 dy prej ekonomive më të fuqishme në botë (Mbretëria e Bashkuara nën qeverinë e Thatcherit dhe ajo e SHBA nën atë të Reganit) bënë një fushatë kundër rolit qeveritar në ekonomi. Ky model ekonomik i frymëzuar nga ekonomia neoklasike apo neoliberalizmi, i njohur gjithashtu si Konsensusi i Uashingtonit, lipste mjedis optimal për investimet kapitale, përfshirë derregullim, eliminim të tarifave dhe të shërbimeve publike, privatizim, dhe të drejta pronësore të rrepta. Kulmin e lulëzimit e pati në vitet 1990 dhe 2000 deri në Recesionin e Madh të viteve 2007-2009.

Një epokë e re multi-polare po ngre krye, ndonëse si me ngurrim.^[3] Në demokracitë liberale të Veriut Global, politika ultranacionaliste ka përçafuar agjendën anti-globaliste për arsye si kulturore ashtu dhe ekonomike, dhe ka shënuar fitore të spikatura zgjedhore me pasoja që nuk kanë fort të ngjarë të ndryshohen e të zbrapsen. Rreshtimi i supremacisë së bardhë, nacionalizmit ekonomik, anti-imigracionit, dhe Islamofobisë ka krijuar një cunami të anti-globalizmit të krahut të djathtë, që ka parakaluar anti-globalizmin e fuqishëm majtists i cili për një kohë të gjatë prodhoi kritika të thella ekonomike, sociale dhe ekologjike të dukurive të çliruara nga globalizimi.

Të dëmtuar thellësisht nga globalizimi, shtetet myslimane qëndrojnë në zgrip të kolapsit politik. Në njërin krah, autokracitë represive në botën myslimane tregojnë shpërfillje të paprecedentë dhe të hapur ndaj interesave të popullësive të tyre dhe ndaj myslimanëve globalisht; në krahun tjetër, pakicat myslimane gjetkë po përballen me një persekutim të paprecedentë gjithnjë e në rritje. Gazetarja dhe akademikja e mirënjohur izraelite Elizabeth Tsurkov e ka përmbledhur si mos më mirë këtë në një cicërimë (*tweet*) të qershorit 2020: “25 vjet mbas Srebrenicës, jetët myslimane nuk kanë qenë kurrë kaq të pavlera sa sot: gjenocid në Kinë, spastrim etnik në Burma, sulme të përsëritura kimike & shfarosje në Siri. Mbas 25 vjetësh, do na kapi tmerri kur të mendojmë mbi këtë epokë të pandëshkueshmërisë së shfrenuar.”

Se si arritëm deri në këtë pikë është një sekret i hapur që nuk thuhet. Skena u ngrit gjatë Luftës së Ftohtë, kur dy superfuqitë i trajtuan këto shtete të porsalindura si fushë shahu të gjeopolitikës. Si rrjedhojë, vendet myslimane qenë veçanërisht të papërgatitura për sulmin e furishëm të korporatave globale të cilat ishin në kërkim të krahut të lirë të punës dhe tregjeve të reja. Teksa bizneset lokale u copëtuan, fitimet nga biznesi global ranë në duart e elitave lehtësisht të korruptueshme dhe të përkulshme nga institucionet kombëtare të dobëta ose gati-gati inekzistente. Teksa paraja e madhe konsumoi politikën në pjesën më të madhe të botës së zhvilluar, në vendet në zhvillim kapitalizmi global shkatërroi me shumë më tepër lehtësi çdo pamje të vetëvendosjes politike dhe nxiti pa limit kapitalizmin me bazë miqësitë, duke acaruar më tej pabarazitë dhe duke ndezur të gjitha llojet e konflikteve fisnore, të vjetra dhe të reja. Pushteti kyç i politikës (qoftë demokratik apo autokratik) – domethënë, rishpërndarja e burimeve dhe shtrëngimi i forcave globale dhe lokale – u zvogëluar kudo.

Ndër pasojat e paqëllimshme por transformuese të botës të kësaj faze të globalizimit, që ndodhi të rastiste me lindjen e internetit, ishte lëvizshmëria e krahut të punës, njohurive, dhe mbi të gjitha, e ndjeshmërive dhe dëshirave. Ndërsa njerëzit shpërnguleshin për punë, korporatat globale u ngulitën

në vende me zhvillim të ulët, por politikisht të qëndrueshëm, për krah të lirë pune; interneti lidhi botën; dhe TV satelitor depërtoi në strukturat komunitare dhe familjare me ide fetare dhe kulturore të konsumerizmit liberal-kapitalist të modernitetit të vonë (kultura më anti-komunitare, individualiste në planet). Dukej se bota po bëhej një fshat (ndonëse një fshat i përkufizuar nga zakonet e Hollywood-it)^[4]

Një tjetër shembull i pasojave të paqëllimshme të globalizimit ishte fenomeni i Al-Jazeera-s, që më pas prodhoi konkurrentë të shumtë. Ky kanal i parë gjysmë i pavarur lajmesh me seli në emiratin e vogël të Gjirit Persik e të pasur me burime nafte e gazi, Katar, i cili punësoi ish-gazetarë të CNN dhe BBC duke revolucionarizuar më pas lajmet në botën arabe, ofroi një raportim global dhe relativisht të ekuilibruar nga një perspektive liberale globaliste, që servirej së bashku me dialogje e debate të hapura, si edhe me kritika ndaj autokracive rajonale dhe ndaj konflikteve kulturore. Ndër faktorët e shumtë, mundësia e kritikizmit politik nga qytetarë, si dhe zëra shpeshherë të heshtur, rikonfiguroi agjensinë politike të njerëzve të zakonshëm. Një numër i këtyre tendencave globalizuese, së bashku me pabarazitë dhe poshtërimet e shfrenuara, të trashura për dekada me radhë nga neoliberalizmi, kulminuan në kryengritjet arabe të vitit 2011. Ato, jo çuditërisht, prodhuan më pas një kundër-revolucion autokratik po njëjloj të fuqishëm të mbështetur nga krahu i djathtë amerikan dhe ai izraelit.

Fundi i shtetit komb

Për t'iu rikthyer skenës globale, le të pyesim se si është transformuar bota nga globalizmi. Studiues të shumtë thonë se globalizmi ka gërryer ose ka transformuar me themel shtetin-komb, sistemin politik që konvencionalisht mendohet se ka zënë fill me traktatin vestfalian të vitit 1648. Ky traktat e fuqizoi Europën që të avanconte përtej qendrave të pushtetit të botës, dhe u përhap në botën jo-perëndimore nëpërmjet kolonializmit dhe anti-kolonializmit. Gërryerja e shtetit-komb, pra, duhet klasifikuar si një ndryshim epokal, jo si një ndryshim i laryshisë së zakonshme të kryengritjeve dhe revolucioneve që ndodhin çdo dekadë apo një herë në disa vjet.

Ndër të shumtit që e konsiderojnë ngritjen e globalizimit, internacionalizmit, dhe neoliberalizmit si fundin e shtetit-komb, sikundërse ne e njohim atë, njëri është studiuesi francez (dhe kreu i misioneve paqeruajtëse të OKB-së në vitet 2000-2008) Jean-Marie Guehenno, i cili në mënyrë profetizuese argumentonte pak kohë mbas rënies së Murit të Berlinit në një libër që doli në vitin 1993 – në po të njëjtin vit që u themelua Bashkimi Evropian – se diçka fundamentale kishte filluar të ndryshonte në raport me Perëndimin: “Viti 1989 shënon përmbylljen e një epoke që filloi jo në vitin 1945, apo 1917, por që u institucionalizua, falë Revolucionit Francez, në vitin 1789. Ky vit sjellë fundin e epokës së shteteve kombe.”^[5] Për më tepër, pretendonte ai, nuk mund të ketë demokraci pa komb. Pikërisht sikurse perandoria romake pasoi republikën romake, po kështu epoka jonë është një perandori me qytetarë të cilët “përbëjnë gjithnjë e më pak një entitet që është në gjendje që të shprehë një sovranitet kolektiv; ata janë thjesht subjekte juridike, mbajtës të të drejtave dhe subjekte të detyrimeve, në një hapësirë abstrakte me kufijë territorialë që janë bërë përherë e më të vagullt.”^[6] Fjalët e tij, që mund të jenë parë si alarmante në atë kohë, vlen që të sillen këtu në një trajtë më të gjerë:

Ky revolucion i ligjeve të pushtetit u shfaq fillimisht në botën e biznesit: fundi i Luftës së Ftohtë tani lejon që ai të zgjerohet në sferën politike; e gjithë bota e industrializuar, nga Uashingtoni deri në Tokio, duke kaluar nëpërmjet Brukselit, po zbulon se rregullat e pushtetit janë duke ndryshuar. Ne besojmë se ka qenë e mjaftueshme që të zëvendësoheshin kombet me superkombet, sikurse një sipërmarrje e gjerë përthith një më të vogël. Ne tani po fillojmë të kuptojmë se, teksa ndryshon në shkallë, pushteti

ndryshon natyrën e tij... Organizimi politik që na la trashëgim Iluminizmi është vetëm një episod në historinë njerëzore, mjeti që ne gjetëm në një etapë të caktuar të zhvillimit tonë për të rrënjësuar lirinë në një rend politik. Ky përkufizim i lirisë nuk do t'i mbijetojë konditave të veçanta që mundësuan lindjen dhe lulëzimin e shteteve kombe. Ne, pra, duhet të kuptojmë rregullat e kësaj epoke të re, jo në mënyrë që të luftojmë kundër saj – kjo do të ishte një orvatje e çuar dëm – por për të shpëtuar atë se çfarë mund dhe duhet të jetë ideja e lirisë.^[7]

Një komb, gjykonte ai, ishte një ide dallueshëm evropiane; nuk është një grup social, dhe as një grup fetar, as racor apo etnik; është “produkt i një kombinimi unik të faktorëve historikë, dhe nuk mund të reduktohet kurrësi në një dimension të vetëm ... ai i bën njerëzit bashkë, jo për atë që ata janë, por për kujtesën e asaj çfarë ata kanë qenë.” Në fakt, “Një komb nuk ka asnjë përkufizim tjetër, përveç atij historik.” E megjithatë, nuk është fis; “një komb, në përkufizimin evropian të fjalës, është pikë së pari një vend; domethënë, një territor i mbrojtur nga kufinj të saktë.”^[8] Duke pasur parasysh këtë, nuk është habi që ideja e kombit është një ide efemerale. “Si produkte nga një brum evropian,” shkruan Guehenno, duke iu drejtuar evropianëve të tjerë si ai, por ky vëzhgim i zbatohet po njëllëj edhe mendjeve të kolonializuara kudo, “ne jemi mësuar që ta konsiderojmë kombin si një formë politike që është vetvetiu e qartë, një lloj kulminimi i natyrshëm i të gjitha shoqërive. Ka ardhur koha që të kuptojmë se ideja e kombit që Europa i dha botës është ndoshta vetëm një formë efemerale, një përjashtim evropian, një tranzicion plot rreziqe ndërmjet epokës së mbretërve dhe epokës ‘neo-imperiale’.” Globalizimi – ndonëse ai nuk ka përdorur këtë fjalë – do të rrezikojë idenë e solidaritetit global që është kondita bazë e politikës dhe e demokracisë.

Më pak se tri dekada më vonë, mbas një orteku rekuiemesh studimore për ditët më të mira të demokracisë amerikane apo të vetë demokracisë, ne nuk jemi bërë më të mençur në lidhje me paradokset e thella të globalizimit. Ajo për të cilën ne jemi të sigurtë është se gjenerata e re e rritur kudo është më thellësisht e zhgënjyer nga bota se sa çdo gjeneratë tjetër që ne mbrauamë në kujtesën e afërt. Për shkak të kolapsit iminent ekologjik dhe pabarazive shtypëse që mund të lidhen fuqimisht me veprimtarinë kapitaliste globale, terreni për zhgënjim vështirë se ka qenë kaq i fortë.

Pavarësisht nga shqetësimet morale dhe ekzistenciale në lidhje me globalizmin, ne gjithashtu duhet të ndjekim akademizmin që është përpjekur ta teorizojë atë. Njëri prej interpretimeve mbizotëruese të globalizmit ka qenë se “shfaqja e juridiksioneve të mbivendosura e shteteve kombëtare sot, institucionet supranacionale, dhe regjimet reja private globale” i përngajnë botës (evropiane) të shtetit para-komb, “gjeografisë politike me shumë fytyra të rendit feudal.”^[9] Sociologia hollandezo-amerikane Saskia Sassen e cilëson globalizimin si një “ndryshim themeltar” në sistemin kompleks të shteteve kombe, një sistem ky i karakterizuar nga “ndërvartësia në rritje” e shteteve “dhe formimi i sistemeve globale”. Ky ndryshim, argumenton ajo, po ndodh në strukturat tej mase komplekse dhe të fuqishme të shtetit komb, që është “njësia që ka përthithur të gjitha blloqet kryesore sendërtuese të shoqërisë përgjatë disa shekujve.”^[10] Me fjalë të tjera, shteti komb është tejet i madh që të dështojë, apo që thjesht të zhduket – në botën e zhvilluar, sidoqoftë. Më saktë, ai po transformohet, po bëhet vatra e transformimeve që po ndodhin, si dhe ndërmjetësi i tyre. Proceset e “denacionalizimit”, që identifikohen si globalizim, bashkëekzistojnë dhe konkurrojnë me procese më të vjetra. Teksa ne mendojmë mbi deglobalizimin, mendimet e Sassen duhet të na nxisin që ta mendojmë atë jo si rilindje apo rikthim i pozicionit qendror të shtetit komb, por si një set kompleks dhe me fund të hapur i proceseve dhe negociatave të shumta të cilat kanë një rezultat të pasigurtë dhe që nuk dihet kur ndodh. Studimet sugjerojnë se ndërkohë që bota e post-globalizmit nuk ka të ngjarë të kthehet në botën e shteteve-kombe të para-globalizmit, se çfarë pamje do të ketë ajo dhe cilët do të jetën fituesit dhe humbësit nuk

është e paracaktuar. Kjo do të varet nga ajo se si do të luftohen betejat, qytet pas qyteti dhe rajon pas rajoni.

Deglobalizimi: Motorë dhe kuptime

Njëri korpus i literaturës që merret me deglobalizimin e barazon atë me rënien e hegjemonisë mbarëbotërore amerikane dhe tranzicionin nga një botë njëpolare në një botë shumëpolare në arealet ekonomike, politike, dhe madje edhe ato kulturorë. Në një raport të vitit 2012, Këshilli Kombëtar i Inteligjencës, agjensia kryesore e inteligjencës e Uashingtonit, doli në konkluzionin se: “Aty nga viti 2030, asnjë vend... nuk do të jetë fuqi hegjemonike... duke kthyer gjerësisht mbrapsht ngritjen historike të Perëndimit që nga viti 1750. Azia do të ketë kapërcyer Amerikën e Veriut dhe Europën së bashku në terma të fuqisë globale, bazuar mbi GDP-në, madhësinë e popullësisë, shpenzimet ushtarake, dhe investimin teknologjik. Vetëm Kina ka të ngjarë të ketë ekonominë më të madhe, duke ia tejkaluar Shteteve të Bashkuara pak vite përpara 2030-ës.”^[11] Historiani Alfred McCoy ka argumentuar në artikullin e tij të vitit 2019, me titullin “Fundi i Rendit Tonë Botëror është Iminent”, se “Të paktën 200 perandori janë ngritur dhe kanë rënë gjatë rrjedhës së historisë, dhe Shtetet e Bashkuara nuk kanë për të qenë përjashtim.” Arsyet që McCoy jep përfshijnë, krahas të ashtuquajturave forca të pafrenueshme të historisë, zhvillime më specifike siç është ngritja e Kinës (që McCoy beson se ka të ngjarë që të jetë ogurzezë për këdo që është i shqetësuar për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit), dhe, më e madhja nga të gjitha, ndryshimi klimaterik.

Një tjetër korpus studimor fokusohet mbi teknologjinë dhe impaktin e saj ekonomik dhe ushtarak. Ekonomisti gjerman dhe themeluesi i Forumit Ekonomik Botëror Klaus Schwab flet për “Revolucionin e Katërt Industrial”. I pari në këtë varg të transformimeve themelore sociale ishte revolucioni industrial i shekullit të tetëmbëdhjetë i nxitur nga forca e avullit, i dyti nga elektriciteti në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, dhe i treti revolucioni digjital i fundit të shekullit të njëzet. Transformimi i katërt, pretendon Schwab, do të jetë edhe më i madh. Strategu ushtarak dhe historiani amerikan T.X. Hammes argumenton se njëri rezultat madhor i Revolucionit Industrial të katërt do të jetë deglobalizimi.^[12] Teksa avantazhet e kostos së punës dhe dallimet teknologjike në manufakturë bien, prodhimi i energjisë do të bëhet lokal dhe jo i varur nga nafta, dhe çdo rajon tanimë do të jetë në gjendje që të prodhojë lokalisht, duke çuar në “rënie të mëdha në lëvizjen globale të tregtisë, shërbimeve, dhe investimeve – shkurtimisht, në deglobalizim.” Rritja ekonomike tanimë do të jetë “e fokusuar në tregje rajonale, në kundërdallim me tregtinë ndër-rajonale apo globale”. Duke jetësuar idenë me ndikim të madh të propozuar në vitet 1990 nga Michael E. Porter i Harvard Business School, që varet nga avgantazhi konkurrues i kombeve mbi tufëzat e firmave, furnizimeve, industrive, dhe institucioneve të ndërlydhura (në vend se, le të themi, lëndë e parëm, sistem politik, apo muskuj ushtarak), Hammes kumton se “biznesi do të bëjë më tepër para duke prodhuar dhe shitur si të mira dhe shërbime në rrafsh rajonal madje edhe lokale se sa në nivel global.”^[13] Ushtarakisht, argumenton Hammes, intervencionizmi dhe policimi amerikan do të duhet të kthehet mbrapsht në mënyrë dramatike teksa aktorë relativisht të vegjël do të jenë në gjendje që të riprodhojnë teknologji ofensive luftime dhe të ndryshojnë pozicionin ushtarak të fuqive të mëdha.

Argumentimi në favor të deglobalizimit

Përpara *Occupy (Pusho) Wall Street* (që protestonte kundër pabarazisë në rritje) dhe Black Lives Matter (që proteston kundër brutalitetit policor dhe racizmit sistemik) që kanë tronditur zemrën e

kapitalizmit global, kishim Betejën e Siatëllit në vitin 1999, kur mbi 40,000 protestues u mbledhën për të protestuar kundër globalizmit. “Organizatorët,” shkruan studiuesi i financës Noah Smith, “ishin një mishmash grupesh – sindikata të shqetësuara për konkurrencën nga krahu i lirë i punës jashtë vendit, ambjentalistë të shqetësuar për *outsourcing* të veprimtarive ndotëse, grupe të mbrojtjes së konsumatorëve të shqetësuar për importet e pakontrolluara të mallrave, grupe për të drejtat e punës të shqetësuar për kushtet e këqija të punës në vende të tjera, dhe majtistë të tipeve të ndryshme që thjesht zbraznin zemërimin e tyre ndaj kapitalizmit.”^[14] Debati ndërmjet globalistëve dhe antiglobalistëve ka qenë i vrullshëm gjatë dekadave të fundit, dhe asnjëra palë nuk ka arritur një fitore vendimtare. Globalizmi pa dyshim ka shtuar disafish pasurinë totale, por në qoftë se justifikimi i tij moral ishte zhdukja e varfërisë, atëherë historiku i tij është dëshpërues. Sikurse ka thënë ekonomisti i Universitetit Berkley, Pranab Bardhan, në një artikull të tijin fill përpara Recesionit të Madh të 2007-ës të titulluar “I ndihmon apo i lëndon globalizmi të varfërit e botës?”, ka dalë në konkluzionin se efekti faktik mbi eliminimin e varfërisë lë shumë për të dëshiruar. Është e vërtetë se shumë njerëz janë larguar nga varfëria në Kinë (nga 70 në 27%), Indi (nga 63 në 42%), dhe në Indonezi (nga 55 në 11%) gjatë dekadave të fundit, por pjesa më e madhe e atij ndryshimi ka ndodhur përpara përsheptimit të globalizimit në vitet 1980: nga 400 milionë në Kinë të cilët me sa duket kapërcyen vijën e varfërisë, 300 milionë e kishin arritur tashmë këtë përpara vitit 1987 si rezultat i reformave shtetërore dhe ekspansionit të infrastrukturës. Ngjashëm, në Indi dhe Indonëzi, ndryshimi mund t’i atribuohet faktorëve të tjerë si Revolucioni i Gjelbërt.^[15]

I kuptuar si ekspansion global i kapitalizmit, globalizmi në vetvete nuk i ka ndihmuar të varfërit. Në vend të kësaj, ka prodhuar pabarazi të stërmëdha me disa pak fitues kolosalë dhe shumë, shumë humbës. Megjithatë, pasojat e mëtejshme (përtej ekonomisë) janë shumë më të mëdha dhe shumë më komplekse. Ato janë ndjerë në sferat kulturore, sociale, politike, dhe ekologjike. E fundmja e këtyre është ndoshta i vetmi domen në të cilin impakti mund të matet në mënyrë shkencore dhe me saktësi. Shkatërrimi i mjedisit të planetit është gjithashtu edhe faktori më jetëgjatë, dhe, sipas të gjitha standarteve të imagjinueshme, më vendimtari si në vlerësimin e performancës së globalizmit ashtu dhe në gjykimin e të ardhmes së tij. Paradoksi është se ndërkohë që kapitalizmi global ka agravuar, pa asnjë faktor tjetër në veprim, problemin e ngrohjes globale dhe degradime të tjera ekologjike, bashkëpunimi global dhe bashkëpunimi shkencor duket se janë të domosdoshëm në zbutjen e disa prej pasojave të tij.

Politikisht, kapitalizmi global duket se ka minuar demokracinë, vënien përpara përgjegjësisë të elitave, si dhe fuqinë e politikës kudo, madje edhe në qoftë se pasojat e aspekteve të tjera të globalizmit (siç është lëvizja e përmirësuar e njerëzve, ideve, dhe informacionit) janë më pak të qarta. Filozofë të dorës së parë kanë shprehur shqetësimin – në mos tmerrin – përballë asaj që kapitalizmi i globalizuar duket se i ka bërë demokracisë dhe jetës së mirë. Jo shumë kohë mbas librit të Guehenno, filozofi britanik John Gray botoi librin *False Dawn: The Delusions of Capitalism* (Agimi i rremë: Iluzionet e kapitalizmit), njëra nga kritikantët më të forta të versionit të globalizuar të kapitalizmit të tregut të lirë, që mbron ekonominë kejejian si një domosdoshmëri për një social-demokraci brenda shtetit-komb. Tregu i lirë apo ekonomia e “dorës së padukshme”, pretendonte Gray, është një ideologji e rrezikshme që është vërtetuar vazhdimisht se është e rreme. Ajo sendërtohet gjithmonë nga pushteti shtrëngues, dhe shkakton vuajtje të mëdha njerëzore. E vërteta është se tregjet e lira janë krijesa të fuqisë shtetërore, dhe vijojnë të ekzistojnë vetëm për sa kohë që shteti është në gjendje të parandalojë që nevojat njerëzore për siguri dhe kontrollin e riskut ekonomik të gjejnë një shprehje politike.”^[16] Ironikisht, pra, “Tregjet e penguar janë norma në çdo shoqërisë, ndërsa tregjet e lira janë produkt i artificit, projektimit dhe shtrëngimit politik.” Në qoftë se tregu i lirë është një proces shtrëngues brenda shtetit

komb – një komunitet ky që ka histori, interesa dhe fat të përbashkët – çfarë lloj ferri duhet ndezur në mënyrë që bota të bëhet një treg i lirë?

Raporti i vitit 2020 Departamentit për Ekonominë dhe Çështjet Sociale (DESA) i OKB-së paralajmëron se “Pabarazia në rritje ka krijuar pakënaqësi, ka thelluar ndasitë politike dhe mund të çojë në konflikt të dhunshëm.”^[17] Raporti gjithashtu vë në dukje ngritjen e rrezikshme të populizmit apo nacionalizmit etno-kulturor në ekonomitë e mëdha demokratike. Studiuesit janë të ndarë mbi faktin nëse ngritja e nativizmit është e shkaktuar nga faktorë ekonomikë apo kulturorë.^[18] Numri i migrantëve në rang botëror u rrit nga 36 milionë në vitin 1991 në 191 milionë në vitin 2005, duke shkuar më tej në 272 milionë në vitin 2020.^[19] Si në SHBA ashtu dhe në Mbretërinë e Bashkuar, “faktori më konsistent që parashikonte se si kanë votuar njerëzit që niveli arsimor” dhe jo të ardhurat, gjë që sugjeron një shpjegim kulturor. Globalisht, mirëbesimi në Kombet e Bashkuara dhe në aktorët e bashkëpunimit ndërkombëtar në rrafsh global po bie (përqindja e atyre që ishin “jo-mirëbesues” u rrit nga 40 në 48 midis viteve 2000 dhe 2010).^[20] Në përmbyllje, ndërkohë që është e rëndësishme, vetëm ekonomia nuk mund të shpjegojë spostimin kryesor drejt antiglobalizmit në vendet e Veriut Global.^[21]

Studiuesit kanë argumentuar prej kohësh se pasojat më të këqija të globalizmit nuk kanë qenë pabarazia ekonomike dhe institucionet shtrënguese, por ato ishin tejet më të thella: mosbesimi i kudogjendur në një botë ku mjerimi nuk projektohet nga askush por ndihet nga pjesa më e madhe, degradimi i jetës sociale, degjenerimi i demokracisë në një premtim bosh, dhe ngritja e grupeve të zemëruara që kërkojnë deshtë kurbanë për t’i fajësuar. Sociologu Zygmund Bauman ka shkruar: “Një pjesë e pandashme e proceseve globalizuese është segregacioni, ndarja dhe përjashtimi hapësinor progresiv.” Një shembull se çfarë nënkuptonte ai me këtë mund të dëshmohet në çdo qytet në botën në zhvillim ku ata pak të pasur jetojnë në komunitete të rrethuara me kangjella që riprodhojnë lagjet më dekadente të Veriut Global, ndërkohë që të varfërit urbanë si edhe masat rurale përjetojnë ferrin tokësor të ndotjes, pafuqishmërisë politike, dhe zhvendosjes fetare dhe shpirtërore. Për më tepër, terrorizmi, ultra-nacionalizmi, fanatizmi fetar, dhe forma të tjera të tribalizmit besohet se janë produkt integral i globalizmit. “Tendencat neo-tribale dhe fundamentaliste,” ka shkruar Bauman, “që reflektojnë dhe artikulojnë përvojën e njerëzve në anën tjetër receptuese të globalizmit, janë po aq pjellë legjitime e globalizmit sa dhe ‘hibridizimi’ i brohoritur i top kulturës – kulturës në majën e globalizuar.”^[22]

Ndër mbrojtësit më të thukët dhe më jetëgjatë të deglobalizimit është sociologu, ambientalisti dhe politikani filipinas Walden Bello. Problemi themelor në pikëpamjen e Bello-s është mbiprodhimi kapitalist-industrialist, që nga ana tjetër ishte rezultat i një numri faktorësh që përkuan njëkohësisht mbas Luftës së Dytë Botërore, siç ishin “kërkesa konsumatore e pas-luftës, rindërtimi i Europës, shpenzimet ushtarake amerikane, dhe zhvillimi i shpejtë ekonomik në botën e dekolonizuar,” pikërisht po të njëjtët faktorë që në SHBA krijuan “epokën e artë të kapitalizmit”.^[23] Ky “muaj mjalti” e pati fundin në krizën e dyfishtë të stanjacionit dhe inflacionit që teoria ekonomike keqnesiane nuk mund ta paraprinte apo shpjegonte. Për të zgjidhur problemin e mbiprodhimit, elita kapitaliste ndoqi tri zgjidhje: ristrukturimin neoliberal, globalizimin dhe financializimin. Për t’u marrë me mbiprodhimin dhe rënien e fitimeve, sfera gjysmë-kapitaliste dhe jo-kapitaliste si Kina u sollën në tregun global për të ofruar krahe të lirë pune, lëndë të parë, dhe tregje të reja. Kjo vetëm sa rriti kapacitetin prodhues dhe mbiprodhimin. Financializimi, gjegjësisht krijimi i kredisë dhe spekulimi (proces ky i njohur që nga antikiteti në formën e tij esenciale si fajde) u bë edhe më i intensifikuar, sikurse ka vërejtur Marks:

Për zotëruesin e kapitalit të parasë, procesi i prodhimit duket thjesht një hallkë lidhëse e ndërmjetme që nuk mund të shmanget, si një e keqe e domosdoshme për hir të të bërit të parave. Të gjitha kombet

që kanë një mënyrë kapitaliste të prodhimit mbërthehen periodikisht nga një përpjekje e zjarhtë për të bërë para pa ndërhyrjen e procesit të prodhimit.[\[24\]](#)

Kjo çoi në krizën financiare dhe Recesionin e Madh të viteve 2007-2009, dhe rindezi teorinë ekonomike keqnesiane në epokën Obama – por ç'është më domethënëse, ajo i dha hov kthimit të elitës globale drejt deglobalizimit. Ndër faktorët kyçë që kontribuan në mungesën e stabilitetit të globalizimit, sugjeron Bello, është vartësia nga tregjet e huaja dhe mbiprodhimi. Ekonomia kapitaliste e globalizuar është e brishtë, e prirë për të rënë pre e krizave, dhe përfundimisht shkatërrimtare për shkak se ajo mbahet e lidhur nga fille të gjatë dhe të hollë dhe jo nga litarët e shkurtër dhe të trashë të ekonomisë rajonale.[\[25\]](#)

Mbrojtja e deglobalizimit në formën e nacionalizmit ekonomik apo rajonalizmit është parashtruar si nga e majta ashtu dhe nga e djathta. E djathta është kthyer kundër globalizimit ekonomik, për shkak të humbjes së vendeve të punës dhe rritjes së numrit të punonjësve emigrantë, si të kualifikuar ashtu dhe të pakualifikuar, nga bota në zhvillim, dhe transferimi i vendeve të punës drejt tregjeve të lira dhe që janë në rritje e sipër dhe humbja konsekuente e vendeve të punës dhe e statusit (duke sjellë kështu rënien e përkohshme nga epoka e artë e rastësishme e kapitalizmit e përmendur më sipër) – krahas ideologjisë së pavarësisë dhe eksepcionalizmit amerikan. Ndërkohë, e majta është e shqetësuar me hallet ekologjike, të drejtat e punës, dhe gërryerjen e demokracisë që Wolin e ka quajtur ngritja e totalitarizmit të përmbysur.

Argumenti konservator: Deglobalizim për të shpëtuar tregun e lirë të vërtetë, komunitetin, dhe/ose karakterin kombëtar

Le t'ia fillojmë me disa kritika konservatore nga Shtetet e Bashkuara, që është dhe zemra e kapitalizmit. Shkencëtarët politikë e ndajnë kundërvënien konservatore ndaj globalizimit në disa kategori. Kritikat janë të shumta dhe disa janë reciprokisht përjashtuese. Kemi mbrojtësit libertarian të tregut të lirë të cilët vënë në dukje, në përputhje me kritikët majtistë (dhe me të drejtë), se kapitalizmi global faktikisht nuk është një treg i lirë, por një marrëveshje *rent-seeking* (ku kërkohet të rritet pasuria e dikujt pa rritur pasurinë e përgjithshme sh.p.) midis qeverisë dhe bizneseve të mëdha; aksesit global në tregjet e lira i siguroar në këtë mënyrë i çliron këta të fundit nga ballafaqimi me konkurrencën e lirë e të ndershme nga tregu. Konservatorët më pak radikalë, ndërkohë që mbështesin kapitalizmin dhe rritjen, thjesht kërkojnë “të ngadalësojnë hapin e ndryshimit për të zbutur pasojat e pafavorshme mbi punonjësit dhe komunitetet që mbahen nga tregje globalisht më pak kompetitive.” Konservatorët socialë të cilët çmojnë komunitetin, familjen, dhe zakonet morale, e shohin globalizmin me më pak sy të mirë, pasi ata i druhen thërrmimit të komunitetit, solidaritetit, dhe virtyteve republikane kur njerëzit u nënshtrohen forcave impersonale të tregut global. James Rogers i përmbledh këto shqetësime me mjaft elokuencë:

Kostoja e sistemit të tregut sipas kësaj pikëpamjeje është humbja e solidaritetit në gjirin e njerëzve. Komentatorë të ndryshëm theksojnë aspekte të ndryshme të këtyre kostove sociale. Njëra linjë thekson idenë se komodifikimi i krahut të punës shkatërron lidhjet e solidaritetit ndërmjet njerëzve në komunitetet lokale. Ka një version të drejtpërdrejtë të kësaj pikëpamjeje, se tregu, dhe anonimatit ndërmjet prodhuesit dhe konsumatorit, domosdoshmërisht na bën që t'i trajtojmë njerëzit e tjerë si mjete dhe jo si qëllime në vetvete. Disa shtojnë gjithashtu se tregu krijon një mjedis semiotik që ndryshon mënyrën se si ne mendojmë për njerëzit që i shohim në jetën e përditshme. Si pasojë, jeta

sociale bëhet e depersonalizuuar dhe e orientuar kah shkëmbimet. Rezultat i kësaj janë izolimi dhe anomia. Të tjerë tërheqin vëmendjen tek përmasa hapësinore e tregut global: ndryshe nga tregjet para-modernë, thotë ky argument, përmasa e plotë e ekonomisë së sotme të globalizuar i bën prodhuesit dhe konsumatorët të huaj për njëri tjetrin. Vetëm çmimi shërben si ndërmjetës midis një personi dhe një tjetri. Kjo pengon aftësinë për të formësuar shkëmbimet ekonomike në mënyrë që t'i shërbejnë nevojave të individëve specifikë, siç mund të bëhet në transaksionet sy për sy në tregjet lokale. Ky ndryshim gjithashtu minon mundësinë që komunitetet reale të qëndrojnë në këmbë, madje edhe në nivel lokal: prodhimi lokal është prodhim për konsumatorët të cilët mund të jenë mijëra kilometra larg. Sipas kësaj pikëpamjeje në sistemin e tregut modern humbet komponenti i marrëdhënies intime i tregjeve lokale.^[26]

Më tepër se sa për komunitetin dhe solidaritetin lokal, nacionalistët ekonomikë (një tjetër tip i konservatorëve) shqetësohen më tepër për përkeqësimin e karakterit lokal nëpërmjet imigrimit dhe fuqisë në rritje të institucioneve globale në përcaktimin e politikës dhe kulturës; kjo tendencë e fundit mund të rroket më së miri në rastin e shqetësimeve nacionaliste që u panë në rastin e Brexit. Këto dy tipe të shqetësimit nuk janë reciprokisht përjashtues, por ato janë të dallueshëm, pasi kapitalizmi nacional amerikan përpara globalizmit kishte kohë që kishte rrënuar solidaritetin lokal familjar dhe komunitar si dhe normat etike. Tashmë është e qartë se libertarianët, komunitarianët, dhe nacionalistët ekonomikë pajtohen për pak gjëra, madje edhe kur janë në përputhje në lidhje me kundërvënien e tyre ndaj ideologjisë globaliste.

Argumenti i të majtës liberale: Deglobalizim për të shpëtuar mjedisin, demokracinë, dhe kulturat e ekonomitë lokale (jo-perëndimore)

Gjatë pesëqind viteve të fundit, siç thotë argumenti i mirënjohur i sociologut Immanuel Wallerstein në teorinë e tij të sistemeve botërore, bota ka mbetur mprehtësisht e ndarë ndërmjet *qendrës* kapitaliste (bota e Atlantikut, ndonjëherë e quajtur Veriu Global) dhe *periferisë* globale (ndonjëherë e quajtur Jugu Global). Impakti i globalizimit ka qenë së tepërmi i madh mbi këtë të fundit, sidomos mbi ato vende të cilave u mungon kapaciteti institucional dhe politik për t'u bërë ballë ndërhyrjes dhe joshjeve të kapitalit global dhe lëkundjeve rrënuese të tregut. Për të rikapitulluar argumentin majtist kundër globalizmit, le t'i rikthehemi fillimisht një pikëpamjeje nga *periferia*, asaj të sociologut filipinas Walden Bello, i cili e popullarizoi termin deglobalizim në monografinë e tij të vitit 2004 me këtë emër ku ai ofroi një argument të shumëanshëm në favor të deglobalizimit. Në një ese të vitit 2008 ai ka argumentuar se “dinamikat e kapitalizmit global janë qenësisht trazuese nga pikëpamja ekologjike.” Në një libër më të vonë, *Capitalism's Last Stand: Deglobalization in the Age of Austerity* (Qëndresa e Fundit e Kapitalizmit: Deglobalizimi në Epokën e Masave Shtrënguese), ai zhvillon argumentet e tij të mëhershme në dritë të ngjarjeve profetike të viteve të ndërmjetme dhe debaton se “rregullimet ekonomike jo-kapitaliste të deglobalizuara duket se janë një pjesë kyçe e zgjidhjes së sfidës të ndryshimit klimaterik dhe formave të tjera të degradimit mjedisor.”^[27] Teksa kapitalistët globalë i bëjnë qëndresë masave të imponuara nga qeveria, siç janë kufijtë e sipër të detyrueshëm të emetimit të karbonit, elitat në ekonomitë në ngritje të Jugut Global tregojnë “pak gadishmëri për t'u ndarë nga modeli “ritje e lartë – konsum i lartë” i trashëguar nga Veriu.”

Ndërsa Kejnsonianizmi figurizoi një kapitalizëm të shtrënguar nga demokracia, filozofi politik amerikan Sheldon Wolin ka argumentuar se rendi botëror neoliberal figurizon demokraci të shtrënguar nga

maksimizimi ekonomik i kompanive shumëkombëshe. Për Wolin, globalizimi nuk është një proces i pashmangshëm dhe pa udhëheqës, por është rezultat i rrëshkitjes së superfuqisë globale në atë që ai e quan “totalitarizëm të përmbysur”, i nxitur nga elita neo-konservatore nën nidekimin e së cilës Shtetet e Bashkuara të pas Luftës së Ftohtë, rishtazi triumfuese, përqaftuan një “imagjinare të pushtetit” dhe jo një imagjinare të parimeve kushtetuese dhe demokracisë, dhe kjo nëpërmjet gjyslykeve të pushtetit total të projektuar globalisht nëpërmjet mijëra bazave ushtarake (të projektuara virtualisht nëpërmjet medias satelitore, si në rastin e dy Luftërave të Gjirit), dhe, financiarisht, nëpërmjet Luftës së pasosur globale ndaj Terrorit e shpallur mbas sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Turravrapi global i superfuqisë me anë të këtyre mjeteve dhe të tjera si këto minoi demokracinë dhe shtrëngimet kushtetuese në vend:

Totalitarizmi i përmbysur shënon një moment politik kur pushteti korporativ e flak tutje identifikimin e tij si një dukuri pastërtisht ekonomike, e kufizuar pikë së pari në një sferë të brendshme të “sipërmarrjes private”, dhe evoluon në një partneritet globalizues me shtetin: një transmutacion i dyfishtë, si i korporatës ashtu dhe i shtetit. E para bëhet më politike, i dyti më i orientuar kah tregu. Kjo amalgamë e re politike operon duke racionalizuar politikën e brendshme në mënyrë që ajo t’u shërbejë nevojave si të interesave korporative ashtu dhe të atyre shtetërore, ndërkohë që mbron dhe projekton po të njëjtat interesa në një mjedis global gjithnjë e më të luhatshëm dhe më kompetitiv.^[28]

Kjo nuk është e vërtetë vetëm për Shtetet e Bashkuara: ka diçka të qenësishme në lidhje me shkallën në të cilën globalizmi na detyron të gjithë që të mendojmë dhe të mësojmë, gjë që e bën atë të jetë në opozitë me çdo lloj të politikës pjesëmarrëse, përfshirë dhe demokracinë. Refreni i pareshtur i ekspertëve është se njerëzit duhet të edukohen në lidhje me çështjen për të cilën ata kanë rastin të jenë ekspertë ose të fokusohen mbi çastin – dhe lista e temave të tilla, ku secila kërkon një zotërim mjeshëtor e të tejzgjatur të një fushe, fare lehtë shkonë në mijëra. Kjo pashmangshmërisht çon, në rrethanat më të mira, në “qeverisjen e ekspertëve”; ajo gjithashtu nënkupton se informacioni i domosdoshëm për të marrë madje edhe vendime që janë modestisht të rrënjësura në formim është i bazuar mbi informacion të abstraguar të pakëtuar dhe ripaketuar për konsum të lehtë nga ata që janë mjeshtra të shpërndarjes, dhe jo domosdoshmërisht mjeshtra të temës së veçantë për të cilën flitet. Kjo lehtëson shfaqjen e njerëzve të famshëm dhe të populizmit, dhe jo të politikës pjesëmarrëse dhe të angazhuar, dhe as të liderëve të aftë që të frymëzojnë dhe të fuqizojnë më të mirët dhe të ndrydhin impulset më të këqija të turmës. Dija mbi të cilën veprojnë edhe njerëzit më të informuar, në kushte të tilla është tej mase abstrakte dhe jo e natyrshme, jo e prekshme dhe jo multidimensionale, në kundërdallim me dijen që dikush ka mbi mjedisin e tij imediat, familjen, dhe komunitetin.

Së fundi, rrjedhojat ndoshta më të rëndësishme njerëzore të globalizmit janë kulturore dhe fetare. Për myslimanët, si për ata të shqetësuar me mënyrat e tjera të jetesës (si kinezët, indianët, afrikanët, dhe, sikurse vihet në dukje, edhe për shumë qytetarë të vetë Veriut Global), globalizmi ka parashtuar një kërcënim kulturor të paprecedentë për atë që ata e çmojnë më së shumti në lidhje me mënyrat e tyre përkatëse të jetesës. Shoqëritë euro-amerikane, të kërcënuara nga imigrimi pikërisht nga ato toka që korporatat e tyre kanë shkretuar, thjesht sapo kanë filluar ta shijojnë helmin që ato kanë shpërndarë gjatë dy shekujve të fundit. Studiues të matur kanë filluar të kuptojnë sfidën e asgjësimit kulturor që faza aktuale e globalizmit parashtron për shoqëritë jo-perëndimore. Antropologu i shquar Clifford Geertz ka shkruar: “Ne duket se kemi nevojë për një varietetet të ri të politikës, një politikë që nuk konsideron theksimin etnik, fetar, racor, linguistik, apo rajonal aq shumë si iracionalitet, arkaizëm dhe të qenësishëm, që duhet ndrydhur apo transhënduar ... Ajo varet nga të zhvilluarit e një qëndrimi më pak thjeshtëzimisht demonizues dhe zbrastazi negativ karshi saj si një relike e ndonjë epoke të egër apo të hershme të ekzistencës njerëzore.” Geertz është treguar tejet naiv nëse ai ka menduar se një

qëndrim më i mirë, dhe arsimimi më i thellë, do të zgjidhte problemin e shkatërrimit të kulturave, gjuhëve, mënyrave të jetesës, dhe mjeteve të jetesës nga globalizmi. Gjetkë, ai ka pikasur një dilemë: bota po bëhet “më globale dhe më e ndarë, më tërësisht e ndërlidhur dhe në të njëjtën kohë më ndërlidhueshëm e copëzuar. Teksa njëra rritet, kështu ndodh edhe me tjetrën.”^[29] Si ka të ngjarë që ndërsa mënyra të tjera të jetës po asgjësohen apo po transformohen me themel, teksa njerëzit bëhen më të perëndimizuara, ata gjithashtu po bëhen më të ndarë? Globalizmi nuk po prodhon një fshat në harmoni – teksa njerëzit po mësojnë të flasin të njëjtën gjuhë dhe po përftojnë të njëjtat dëshira dhe po konkurrojnë për të njëjtat gjëra, ata në të njëjtën mënyrë po bëhen të vetëdijshëm për pabarazitë dhe padrejtësitë.

Pyetje të hapura

Ndërkohë që motori i globalizmit mund të ketë qenë ekonomik, prania e tij reale dhe pasojat e tij afatgjata janë ekologjike, sociale, psikologjike, emocionale, politike, dhe kulturore. Ndjeshmëritë, pritshmëritë, dashuritë, frikërat, ndjesitë, burimet e informacionit, thellësia dhe gama e marrëdhënieve, madhësia e familjes, sjellja familjare, norma e martesës dhe e fëmijëve., përkushtimi ndaj familjes dhe komunitetit, impakti mbi mjedisin, dhe dija e praktika e ritualeve fetare, të gjitha këto kanë pësuar një transformim të thellë.

Pasoja më e padiskutueshme e globalizmit ka qenë përshpejtimi i beftë dhe i patolerueshëm i degradimit ekologjik. Ata që jetojnë në Jugun global kanë edhe mospëlqim edhe admirim për ata që jetojnë në Veri, duke dëshiruar të njëjtin stil jetese. Kjo objektivisht është e pamundur. Amerikanët përbëjnë 5% të popullsisë së botës dhe konsumojnë rreth 35% të burimeve të botës. Madje edhe ngritja e ekonomive të reja është gjerësisht e varur nga konsumatorët e fuqishëm në Veriun global. Liberalizmi modern dhe kapitalizmi janë pazgjidhshmërisht të varur nga një stil konsumarist jetese, domethënë, një stil në të cilin konsumi është një mënyrë e jetës, të drejtën për të cilën gjë amerikanët e kërkojnë në mënyrë militanteske. Në qoftë se këto kondita të jetës individualiste dhe materialiste shtrihen në 70-80% të njerëzimit që ende jeton në kultura më tradicionale – kultura nga të cilat varet ekzistenca jonë e vazhdueshme dhe megjithatë kultura të cilat janë thellësisht të kërcënuara – kjo thjesht do të kishte nevojë për disa planete të tjerë që të realizohej. Krahas kësaj, ndryshimi klimaterik antropogjenik, që është drejtpërdrejt dhe pazgjidhshmërisht i lidhur me industrializimin dhe jetën moderne, ka dëmtuar tashmë planetin në mënyrë drastike. Kërcënime si pandemitë globale, teksa ato bëhen më të shpeshta dhe më serioze, buisin mbi qarkullimin e shpeshtë global të krahut të punës dhe të kapitalit, dhe, pa ndihmën e asgjëje tjetër, mund t'i bien kmëbanës së vdekjes së globalizmit.

E megjithatë, paradoksalisht, zgjidhja e problemeve ekologjike, katastrofave natyrore, dhe pandemive globale, të cilat nuk i respektojnë aspak kufijtë kulturorë apo kombëtarë, kërkon një bashkëpunim global të cilin deglobalizimi e kërcënon. Dija që nevojitet për të mbajtur popullësinë globale në rritje po prodhohet dhe po konsumohet në mënyrë globale. Globalizmi ka mundësuar intensifikimin e ndërveprimit midis kulturave; dhe madje edhe nën hegjemoninë e liberalizmit perëndimor, kulturat jo-perëndimore kanë gjetur zëra të rinj. Edhe ndërsa kritikët vënë në dukje se ato kultura të përtërirë shpeshherë janë shëmbëlltyra të kulturave perëndimore apo reaksione sipërfaqësore ndaj tyre, mundësitë që globalizmi (interneti dhe media sociale, në veçanti) kanë ofruar për dialog, rikonfirmim, dhe lloje të reja solidariteteve, duket se është e paprecedentë dhe e fuqishme.

Si duhet të reagojnë ulemaja dhe liderët myslimanë të opinionit – pra, trashëgimtarët e pejgamberëve – ndaj një bote që po ndryshon thellësisht? Rezultatin nuk do ta vendosin ligjet e pamëshirshme të

shkencës sociale – vetëm vullneti hyjnor mund ta vendosë atë, i cili shpërblen arsytë dhe veprimin e drejtë. Me veprim profetik, spektri i (de)globalizimit mund të shndërrohet, në dashtë Zoti, në një fillim të ri e të mbarë, kështu që e ardhmja e jonë kolektive mund të jetë më e mirë se sa e tashmja jo-reale, në të cilën dëmet e paimagjinueshme pllakosin një grup të ri mysliman çdo ditë, dhe, si qengja të vënë në radhë për në kasaphanë, pjesa tjetër janë në pësjtjellim të plotë, secili duke shtyrë tjetrin drejt teht tekta të gjithë së bashku dalëngadalë i afrohen po të njëjtit teh.

Ovimir Anjum

Bashkë-Editor

American Journal of Islam and Society

Profesor i Katedrës së Studimeve Islame “Imam Khattab”

Departamenti i Filozofisë dhe Studimeve Fetare

Fakulteti i Bashkangjitur, Departamenti i Historisë

Universiti i Toledos, Toledo, Ohio, SHBA

[1] Walden Bello, *Capitalism's Last Stand: Deglobalization in the Age of Austerity* (New York: Zed Books, 2013), 1; “Turning their Backs on the World,” *The Economist*, February 19, 2009, <https://www.economist.com/international/2009/02/19/turning-their-backs-on-the-world>.

[2] Manfred Steger, *Globalization: A Very Short Introduction* (Oxford: Oxford University Press, 2009), 8-9.

[3] Eksperti i shquar Eric Helleiner vëren se ndërkohë që mbajnë dollarin amerikan si rezervën e tyre monetare sot, fuqitë e reja ekonomike po marrin hapa gradualë por definitivë drejt zëvendësimit të rendit aktual global të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara. Kjo është në contrast me konferencën e pas Luftës së Dytë Botërore në Bretton Woods kur fitimtarët e udhëhequr nga Shtetet Bashkuara hartuan një rend të ri nga e para. Shiko, për shembull, leksionin e tij “Legacies of the 2008 Global Financial Crisis,” *YouTube*, https://www.youtube.com/watch?v=lr_YhVpC_GU&t=3185s, duke filluar në min. 45:00 (parë më 24 gusht 2020).

[4] Kjo histori rrëfëhet me mungesën karakteristike të shijes nga gazetari i New York Times Thomas Friedman në libra të tillë si *The Lexus and the Olive Tree: Understanding Globalization* (New York: Farrar, Straus, & Giroux, 1999) dhe *The World is Flat: A Brief History of the Twenty-first Century* (New York: Farrar, Straus, & Giroux, 2005).

[5] *The End of the Nation State* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1995), x.

[6] *Ibid.*, xii.

[7] *Ibid.*, xiii.

[8] *Ibid.*, 4.

- [9] Saskia Sassen, *Territory, Authority, Rights: From Medieval to Global Assemblages* (Princeton University Press, 2006), 27.
- [10] Ibid., 401.
- [11] Cituar ne Alfred Mccooy, *In the Shadows of the American Century: The Rise and Decline of US Global Power* (Chicago: Haymarket Books, 2017).
- [12] T.X. Hammes, *Deglobalization and International Security* (Amherst: Cambria Press, 2019), xiii.
- [13] Ibid., xiii.
- [14] Noah Smith, "The Dark Side of Globalization: Why Seattle's 1999 Protesters Were Right," *The Atlantic*, January 6, 2014, <https://www.theatlantic.com/business/archive/2014/01/the-dark-side-of-globalization-why-seattles-1999-protesters-were-right/282831/>.
- [15] Pranab Bardhan, "Does Globalization Help or Hurt the World's Poor?" *Scientific American*, March 6, 2006, <https://www.scientificamerican.com/article/does-globalization-help-o-2006-04/>.
- [16] John Gray, *False Dawn: The Delusions of Global Capitalism* (New York: The New Press, 1998), 17.
- [17] United Nations Department of Economic and Social Affairs (DESA), "World Social Report 2020: Inequality in a Rapidly Changing World" (United Nations,2020), 20; www.un.org/development/desa/dspd/wp-content/uploads/sites/22/2020/02/World-Social-Report2020-FullReport.pdf.
- [18] Ibid., 51.
- [19] Raporti thotë: "Një kundër-reagim ndaj globalizmit ka qenë një komponent kyç i retorikës së fundit populiste në vendet e zhvilluara. Ka të ngjarë që pabarazia, së bashku me pasigurinë e tregut të punës dhe konsiderata të tjera ekonomike, së bashku me faktorë kulturorë dhe demografikë, kanë luajtur të gjithë një rol në rritjen e populizmit." United Nations World Migration Report 2020, https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/wmr_2020.pdf.
- [20] US DESA, "World Social Report 2020," 167.
- [21] World Migration Report 2020, 52.
- [22] Zygmunt Bauman, *Globalization: The Human Consequences* (Cambridge: Polity Press, 1998), 3.
- [23] Ibid., 4-5.
- [24] Karl Marks siç citohet në Bello, *Capitalism's Last Stand*, 8.
- [25] Bello, *Capitalism's Last Stand*, 23.

[26] James R. Rogers, "Understanding the Conservative Split Over Globalization," *Law and Liberty*, December 20, 2017, <https://lawliberty.org/understanding-the-conservative-split-over-globalization/>.

[27] Bello, *Capitalism's Last Stand*, 164.

[28] Sheldon S. Wolin, *Democracy Incorporated: Managed Democracy and the Specter of Inverted Totalitarianism*, botim i ri (Princeton: Princeton University Press, 2018), 238.

[29] Richard A. Shweder, "Geertz's Challenge: Is It Possible to Be a Robust Cultural Pluralist and a Dedicated Political Liberal at the Same Time?" në *Law without Nations*, ed. Austin Sarat, Lawrence Douglas, dhe Martha Merrill Umphrey (Stanford: Stanford University Press, 2011), 185-231.

Date Created

21/11/2020

Author

ovamir-anjum